

LIGJ
Nr. 69/2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9695, DATË 19.3.2007, “PËR
PROCEDURAT E BIRËSIMIT DHE KOMITETIN SHQIPTAR TË BIRËSIMIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 10, të ligjit nr. 9695, datë 19.3.2007, “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, të ndryshuar, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Të ketë përfunduar studimet në shkencat humane, shkencat juridike ose shkencat sociale, me nivelin e diplomës ‘master shkencor’”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.10.2019.

Shpallur me dekretin nr. 11319, datë 18.10.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta